



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SKRAPAR
KESHILLI**

VENDIM

NR 52 Datë 22.05.2018

Mbi dhënien e Pagesave për aftësinë e kufizuar për muajin Maj 2018

Mbështetur në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 7 dhe neni 29 pika 2 të ligjit 9355, datë 10.03.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, i ndryshuar; V.K.M nr. 618 datë 07.09.2006 “Për përcaktimin e kritereve, të dokumentacionit dhe të masës së pagesës për personat me aftësi të kufizuar”, i ndryshuar; Udhëzim nr. 366, datë 21.9.2017 “Mbi zbatimin e vendimit nr. 618, datë 07.09.2006, të Këshillit të Ministrave për përcaktimin e kritereve të dokumentacionit dhe masës së përfitimit të pagesës për personat me aftësi të kufizuar”; ligjin nr. 8089, datë 28.03.1996 “Për statusin e të verbërit” i ndryshuar, VKM nr. 277 datë 18.06.1997 “Për përfitimet nga statusi i të verbërit” Udhëzimin nr. 367 datë 21.09.2017 “Mbi zbatimin e Vendimit Nr 277 te Këshillit te Ministrave Për përfitimet nga Statusi i të Verbërit”, i ndryshuar ; Ligjin nr. 8626 datë 22.06.2000 “Statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, V.K.M nr. 31 datë 20.01.2001 “Për përfitimet nga statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik” i ndryshuar; Udhëzimin nr. 365 date 21.09.2017 “Mbi zbatimin e Vendimit Nr.31 datë 20.01.2001, të Këshillit të Ministrave “Për përfitimet nga statusi i invalidit, paraplegjik dhe tetraplegjik” i ndryshuar ;V.K.M nr. 869 datë 18.06.2008 “Për zbatimin e ligjit nr. 7889, datë 14.12.1994 “Statusi i invalidit”.Keshilli i Bashkise pasi mori ne shqyrtim propozimin e Sektorit te Ndhimes Ekonomike dhe Paaftesise

VENDOSI :

1. Te përfitojnë **pagesë paaftësie** për muajin Maj 2018 në total 530 persona me fond 6 535 976 lekë, të ndarë në:

- Të paaftë 259 persona me fond 2 851 080 lek ne muaj
- Kujdestarë paaftësie 81 persona me një fond 841 859 lek ne muaj
- Të verbër 116 persona me një fond 1 380 323 lek ne muaj



- Kujdestarë të verbër 26 persona me nje fond 293 250 lek ne muaj.
- Para e tetraplegjike 24 persona me nje fond 631 920 lek ne muaj.
- Kujdestarë para e tetraplegjike 24 persona me nje fond 260 400 lek ne muaj.
- Kompesim për energjinë elektrike 110 persona me fond 267 144 lekë ne muaj.
- Kompseim per telefon 10 persona me nje fond 10 000 lek ne muaj.

2. Përfitojnë pagesë për shkak **Invaliditeti në punë** për muajin Maj 2018 në total 344 persona me fond 1 074 300 lekë.

Miratohet me 13 (trembëdhjete) vota pro,kunder dhe abstenim nuk ka.

Per konfirmim Prefektit te Qarkut.

**KRYETARI I KESHILLIT
PARTIZAN GORÇE**

